



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 618 Prot.

Tiranë, më datë 06.12.2024

**VENDIM**  
**Nr. 518, datë 06.12.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.12.2024:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Resort turistik dhe rezidencial “Sun Palasë” me objekte hotelerie 1-9 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë, dhe objekte banimi 1-4 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Palasë, Bashkia Himarë, me zhvillues subjektet “Golden Key” Sh.p.k. dhe “Sun Palasë” Sh.p.k.;
  2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Resort turistik dhe rezidencial “Sun Palasë” me objekte hotelerie 1-9 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë, dhe objekte banimi 1-4 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
  3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
  4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Sokol ISMAILI**

**KRYETAR**  
**Blendi GONXHJA**